



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2023

VENDIM

Nr.404 , datë 18.07.2023

PËR

**KUALIFIKIMIN PËR EMËRIM TË KANDIDATIT TË DIPLOMUAR NË SHKOLLËN
E MAGJISTRATURËS, Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 18.07.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për emërim si magjistrat, profili gjyqtar, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatori z.Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së emërimit të tij si gjyqtar,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Z. {...} është kandidat për t’u emëruar magjistrat, profili gjyqtar, në kushtet kur ai përfshihet në listën e të diplomuarve për kandidatët gjyqtarë në përfundim të vitit akademik 2022-2023, përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, në përputhje me nenin 34, pika 1/1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji i Statusit), me Shkresën me Shkresën nr.503 prot., datë 30.06.2023, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me aktin nr.3730 prot., datë 30.06.2023.

2. Po ashtu, z. {...} nuk ka kërkuar të emërohet magjistrat në vitin pasardhës, sikurse lejohet nga neni 32, pika 2, i Ligjit për Statusin, sipas të cilit: *“2. I diplomuari që përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, për shkaqe të justifikuara, jo më vonë se dy javë nga data e publikimit të listës së të diplomuarve, mund të kërkojë që të emërohet si magjistrat në vitin pasardhës”.*

3. Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për emërim si magjistrat, profili gjyqtar, në përputhje me nenin 34, pika 1, të Ligjit për Statusin, si dhe Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 56, datë 31.01.2023, vendosi *fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magjistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2022-2023*, duke caktuar relatorin për çdo kandidat, ku në bazë të shortit, për kandidatin z. {...}, si relator u caktua z. Alban Toro.

4. Më datë 31.01.2023, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

5. Brenda afatit treditör, kandidati z. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Më datë 07.02.2023, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatit z. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

7. Brenda afatit pesëditor, kandidati z. {...}, depozitoi në zyrën përkatëse të Këshillit formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ai dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

8. Gjatë procedurës së verifikimit, më datë 14.02.2023, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për gjyqtarë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për z. {...}.

9. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KUSHTET DHE KRITERET LIGJORE TË EMËRIMIT SI MAGJISTRAT, PROFILI GJYQJAR

A. Për kushtet e emërimit

10. Neni 136/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton se: *“1. Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit. 2. Kriteria të tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj”*.

11. Nga kjo dispozitë kushtetuese identifikohen dy kushte emërimi si magjistrat: *“shtetësia shqiptare”* dhe *“përfundimi i formimit fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës”*.

A.1 Për kushtin e shtetësisë shqiptare

12. “Shtetësia shqiptare” është përcaktuar si kriter kandidimi për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, referuar nenit 28, shkronja “b”, të Ligjit për Statusin. Për këtë shkak, ajo është verifikuar në rastin e kualifikimit të z. {...} për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2020 - 2021, sipas Vendimit nr.410, datë 09.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

13. Pavarësisht kësaj, sa kohë kjo rrethanë është e ndryshueshme, në funksion të verifikimit të kushtit të emërimit si magjistrat, profili gjyqtar, të z. {...}, kjo rrethanë verifikua sërish. Gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare për këtë kandidat. Përkundrazi, nga verifikimi i bërë, më datë 07.04.2023, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas certifikatës personale elektronike të printuar në letër nga nëpunësi i ngarkuar i

Këshillit, konstatohet se kandidati vijon të ketë shtetësinë shqiptare, duke përmbushur kështu këtë kusht emërimi si magjistrat, profili gjyqtar.

A.1 Për kushtin e përfundimit të formimit fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës

14. Siç u parashtua, neni 136/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe neni 35, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit të Statusit¹, për t’u emëruar magjistrat, profili gjyqtar, kërkojnë përfundimin e formimit fillestar/diplomimin në Shkollën e Magjistraturës.

15. Bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, përcjellë me Shkresën nr.517 prot., datë 04.07.2023, të Shkollës së Magjistraturës, konstatohet se z. {...} ka përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës gjatë periudhës Tetor 2020- Qershor 2023 dhe në përfundim të vitit akademik 2022-2023 është diplomuar magjistrat, profili gjyqtar, duke përmbushur kështu këtë kusht emërimi si magjistrat, profili gjyqtar.

B. Për kriteret e emërimit

16. Neni 136/a i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka përcaktuar se gjyqtarët emërohen pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit, ndërkohë që kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj. Në bazë të këtij autorizimi kushtetues, Ligji për Statusin, në nenin 35, ka përcaktuar kriteret e emërimit të kandidatit magjistrat të diplomuar.

B.1 Për kriterin e vlerësimit nga Shkolla e Magjistraturës

17. Neni 35, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, të Ligjit për Statusin, për emërimin magjistrat, kërkojnë që kandidati të jetë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme, si dhe të jetë vlerësuar minimalisht “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar.

18. Bazuar në dokumentacionin e kandidatit {...}, përcjellë me Shkresën nr.503 prot., datë 30.06.2023, të Shkollës së Magjistraturës, konstatohet se kandidati z. {...} është diplomuar magjistrat, profili gjyqtar, në përfundim të vitit akademik 2022-2023:

¹ “1. I diplomuari emërohet magjistrat ...”.

- a) me 89.42 % të pikëve, pra “*është diplomuar me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme*”;
- b) është vlerësuar me 600 pikë, domethënë “*shkëlqyeshëm*”, për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar, pra “*është vlerësuar minimalisht “mirë” për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar*”.

19. Nga sa rezulton nga verifikimi, kandidati z. {...} plotëson këto kritere të emërimit si magjistrat, profili gjyqtar.

B.2 Për kriterin e pasurisë

20. Neni 35, pika 1, shkronja “c”, e Ligjit për Statusin, për emërimin magjistrat, kërkon që kandidati të këtë kaluar sërish verifikimin e pasurisë, në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji.

21. Ndërkohë, neni 32 i Ligjit për Statusin përcakton se: “... 2. ... *Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë ..., nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ..., organet e administratës tatimore dhe doganore, ..., si dhe çdo organ publik, person fizik ose juridik që disponon të dhëna të vlefshme për qëllimet e verifikimit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. ... 4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë ... kur: a) burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete duke i fshehur ato, ose në mënyrë të qëllimshme ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve, ose kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit; ...”.*

22. Në rastin e kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, z. {...} i është nënshtruar verifikimit të pasurisë, në përfundim të cilit është konkluduar se ai plotëson këto kritere, referuar Vendimit nr.410, datë 09.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

23. Për verifikimin sërish të kriterit të pasurisë për kandidatin z. {...} u kërkuar raportim nga organet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, i ndryshuar.

24. Konkretisht, u kërkuar raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar, në Këshillin e Lartë Gjyqësor, Raportin nr. 8/23 prot., datë 03.04.2023.

25. Sipas Raportit të ILDKPKI-së, kandidati z. {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

26. Po ashtu, sipas Raportit të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrollet e plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidati, për periudhën mbas kontrollit të plotë pasuror të kryer për të si kandidat për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe deri në datën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, duke konkluduar se për kandidatin:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

27. Për verifikimin sërish të kriterit të pasurisë për kandidatin z. {...} iu kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

27.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me shkresën nr. 2274/1 prot., datë 27.02.2023, ku për kandidatin {...}, nuk jepen të dhëna për aktivitete tregtare

27.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me shkresën nr. 2601/1 prot., datë 08.03.2023, ku për kandidatin {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

28. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga organet si më lart u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t'i kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.

29. Gjatë verifikimit nuk rezultoi nevoja për kërkimin e ndonjë të dhëne tjetër të vlefshme për qëllimet e verifikimit, pranë ndonjë organi publik, personi fizik ose juridik tjetër.

30. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar sa i përket kriterit të pasurisë. Konkretisht verifikohet që:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidati ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e tij;
- ç) deklarimi nga kandidati i pasurisë, aseteve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

B.3 Për kriterin e figurës

31. Neni 35, pika 1, shkronja “c”, e Ligjit për Statusin, për emërimin magjistrat, kërkon që kandidati të këtë kaluar sërish verifikimin e figurës, në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji.

32. Ndërkohë, neni 32 i Ligjit për Statusin përcakton se: “... 2. ... *Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e ... figurës ..., prokuroria, gjykata, ..., Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, ..., si dhe çdo organ publik, person fizik ose juridik që disponon të dhëna të vlefshme për qëllimet e verifikimit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. ... 4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të ... figurës kur: ...; b) kandidati ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar; c) ka shfaqur sjellje të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që cenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ...”.*

33. Në rastin e kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, z. {...} i është nënshtruar verifikimit të figurës, në përfundim të cilit është konkluduar se ai plotësonte këtë kriter, referuar Vendimit nr.410, datë 09.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

34. Për verifikimin sërish të kriterit të figurës për kandidatin z. {...} u kërkuar raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, i ndryshuar.

35. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit z. {...} me persona të përfshirë në

krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

36. Nga raportimi i Byrosë Kombëtare të Hetimit, sipas shkresës nr. 170/1 prot., datë 01.03.2023, nuk rezultoi ndonjë informacion i vlefshëm për qëllimet e verifikimit për kandidatin z. {...}.

37. Për kandidatin z. {...}, në kushtet kur ai, në momentin e kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ka përmbushur detyrimet sipas Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar dhe i është nënshtruar kontrollit sipas këtij ligji, referuar për këtë Vendimit nr.410, datë 09.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në funksion të verifikimit sërish të figurës për të, u kërkua informacion i përditësuar nga Struktura e Posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo e fundit, me shkresën nr. 1310/49 prot., datë 28.03.2023, për kandidatin z. {...} informoi se: - ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 23.07.2020; - formulari është regjistruar me numrin unik 000524; - formulari i vetëdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të web; - nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji; - nga përgjigjet e ardhura nga shërbimi i gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore nuk ka rezultuar ndryshime të dhënave të gjendjes civile dhe gjyqësore, nga ato të deklaruara; - deri më sot nuk ka pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.

38. Për verifikimin sërish të figurës së kandidatit z. {...} u kërkua informacion nga Prokuroria e Përgjithshme, e cila, me shkresën nr. 259/24 prot., datë 29.03.2023, ka dërguar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor informacionin e përcjellë nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm. Sipas informacioneve të administruara, rezulton se *“omissis... pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar procedim penal në ngarkim të kandidatit {...}, konkretisht procedimi penal me nr. 3443 i vitit 2018 që bën fjalë për veprën penale të “Pengimit të ekzekutimit të vendimit të gjykatës”, procedim penal ky që, me Vendimin e datës 02.11.2018, është pushuar nga prokurori mbi shkakun se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Penale...omissis.”* Informacion i cili i është nënshtruar kontrollit për figurën, referuar Vendimit nr.410, datë 09.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për z. i është nënshtruar kontrollit sipas këtij ligji, referuar për këtë Vendimit nr.410, datë 09.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në funksion të verifikimit sërish të figurës për z. {...}. Për sa me sipër vlen të theksohet se sipas informacioneve të administruara, rezulton se *“omissis... z. {...} nuk është marrë në cilësinë e personit në hetim në një ndonjë procedim penal, ndaj tij nuk janë zbatuar masa sigurimi me karakter personal ose pasuror, nuk ka të dhëna për procedime penale të mos filluara, pushuara apo pezulluara, për periudhën Tetor 2020 e në vijim...omissis.”*

39. Për verifikimin sërish të kriterit të figurës për kandidatin z. {...} u kërkua informacion nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila e ka dërguar atë me shkresën nr2349/1 prot., datë 03.03.2023, nga përmbajtja e të cilës nuk rezulton që ndaj kandidatit të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal.

40 Për verifikimin e figurës së kandidateve, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Gjykata e Lartë dhe të gjithë Gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm kanë kryer verifikimin përkatës, të cilat në kohë të ndryshme kanë përcjell pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor informacionin për kandidatët që priten të diplomohen në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për z. {...}. Sipas informacioneve të administruara, rezulton se *“omissis... z.{...} nuk ka asnjë çështje të regjistruar apo vendim të dhënë në ngarkim të tij ..omissis.”*

41. Së fundi, për verifikimin sërish të kriterit të figurës për kandidatin z. {...} u kërkua informacion nga Shkolla e Magjistraturës lidhur me disiplinën e kandidatit gjatë ndjekjes së programit të formimit fillestar për magjistrat në kushtet kur, sipas nenit 255 të Ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i ndryshuar², kandidati për magjistrat është subjekt i përgjegjësisë disiplinore, ndërsa janë organet e Shkollës së Magjistraturës sipas këtij ligji³ ato që kanë përgjegjësinë e verifikimit të ankesave, hetimit të shkeljeve disiplinore dhe procedimit disiplinor të kandidateve për magjistrat. Me shkresën nr.1310/104 prot., datë 10.07.2023, ndër të tjera, Shkolla e Magjistraturës ka informuar se për kandidatin z. {...}, organi disiplinor nuk ka regjistruar procedim disiplinor dhe kundrejt tij nuk është marrë masë disiplinore.

42. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet se për të nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit nga kandidimi dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar sa i përket kriterit të figurës. Konkretisht verifikohet që:

² *“...kandidatët për magjistratë mbajnë përgjegjësi për shkeljet disiplinore, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloren e brendshme të shkollës”.*

³ Neni 256, sipas të cilit: *“1. Prokurori për Disiplinën, i caktuar në përputhje me nenin 248, pika 1, shkronja "gj", kryen verifikimin e ankesave dhe hetimin e shkeljeve disiplinore të pretenduara të kandidateve për magjistratë. Në rast parandalimi ose konflikti të interesave ai përfaqësohet nga Zëvendësprokurori për Disiplinën, i caktuar në përputhje me nenin 248, pika 1, shkronja "gj", të këtij ligji. ...”,* si dhe neni 257, sipas të cilit: *“1. Komisioni Disiplinor që kryen procedimin disiplinor dhe cakton masën disiplinore është i pavarur dhe i nënshtrohet vetëm ligjit. 2. Në rastin e procedimit disiplinor ndaj kandidatit për magjistrat, Komisioni Disiplinor përbëhet nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës si kryetar, një gjyqtar dhe një prokuror të zgjedhur në përputhje me nenin 247, pika 1, shkronja "d", të këtij ligji, si anëtarë të Këshillit Drejtues, dhe dy kandidatë për magjistratë të zgjedhur me votë të fshehtë nga asambleja e kandidateve për magjistratë. ...”.*

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidati ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e tij;
- ç) deklarimi nga kandidati i pasurisë, aseteve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

B.3 Për kriteret e zgjedhshmërisë

43. Neni 35, pika 1, shkronja “c”, e Ligjit për Statusin, për emërimin magjistrat, kërkon që kandidati të këtë kaluar sërish verifikimin e figurës, në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji.

44. Ndërkohë, neni 32 i Ligjit për Statusin përcakton se: “... 4/1. *Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës kur: ...; ç) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit*”.

45. Në kuptim të shkaqeve të tjera përjashtuese në lidhje me pasurinë dhe figurën sipas shkronjës “ç”, pika 4/1, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, sa i përket emërimit si magjistrat, vlen të konsiderohen shkaqet e pazgjedhshmërisë si magjistrat.

46. Shkaqet e pazgjedhshmërisë si magjistrat përcaktohen në nenin 66, pika 1, të Ligjit për Statusin, sipas të cilit: “1. *Statusi i magjistratit mbaron në ditën kur autoriteti kompetent përcakton me vendim shkaqet e pazgjedhshmërisë si vijon: a) kur magjistrati nuk plotëson kriteret e përcaktuara, sipas nenit 28 të këtij ligji; ...*”. Pra, në kuptim të kësaj dispozite, kriteret sipas nenit 28 të ligjit janë në fakt dhe kritere zgjedhshmërie si magjistrat. Po ashtu, kjo dispozitë imponon për Këshillin e Lartë Gjyqësor verifikimin pa u kufizuar në kohë të shkaqeve të pazgjedhshmërisë si magjistrat, madje edhe atëherë kur statusi i magjistratit është fituar. Ndaj, në kuptim të kësaj dispozite, ndërsa statusi i magjistratit mund të mbarojë kur nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 28 të Ligjit për Statusin, atëherë për të njëjtën arsye ai nuk mund ta fitojë këtë status, duke shërbyer në këtë mënyrë kriteret e përcaktuara nga kjo dispozitë edhe kritere zgjedhshmërie si magjistrat.

47. Neni 28 i Ligjit për Statusin përcakton “*Kriteret e pranimit në formimin fillestar*”. Verifikimi i këtyre kriterëve për kandidatin z. {...}, në përputhje me nenin 30 të Ligjit të Statusit, është bërë në momentin e kandidimit të tij për në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, ndërsa ai është lejuar të marrë pjesë në provim, ndërkohë që, në përfundim të provimit të pranimit, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, më datë 19.06.2020, ka miratuar listën e renditjes me rezultatet përfundimtare të shpallura nga Komisioni i Provimit me shkrim dhe nga Komisioni i Vlerësimit të Shëndetit Mendor dhe Psikologjik, të provimit të pranimit për vitin akademik 2020-2021. Në këtë listë është përfshirë dhe kandidati {...}.

48. Gjithsesi, për kandidatin z. {...} është bërë verifikimi sërish i disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar për magistrat në Shkollën e Magjistraturës, në rastin e verifikimit të tij nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si kandidat për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, referuar Vendimit të tij nr.410, datë 09.10.2020.

49. Në rastin e verifikimit sërish të disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar për magistrat në Shkollën e Magjistraturës, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka mbajtur në konsideratë diferencën kohore mes momentit të aplikimit për në provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës (Shkurt 2020), momentit të vlerësimit përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës për plotësimin e kriterëve (qershor 2020), si dhe momentit kur Këshilli është shprehur për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit të tij për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës (tetor 2020). Dhe po ashtu, Këshilli ka mbajtur në konsideratë dhe faktin se shumica e kriterëve të pranimit në formimin fillestar janë potencialisht të ndryshueshëm në kohë (me përjashtim të kriterit arsimor, kriterit të përvojës profesionale, kriterit të anëtarësisë në parti politike, në kohën e kandidimit dhe kriterit të anëtarësisë, bashkëpunëtorit ose të favorizuarit nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990). Gjithashtu, Këshilli ka mbajtur në konsideratë detyrimin e tij konstant për verifikimin e kriterëve të zgjedhshmërisë, të cilat janë njëherazi edhe kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

50. Në kuptim të nenit 28 të Ligjit për Statusin, si kriteret zgjedhshmërie si magistrat identifikohen: *a) zotësia për të vepruar; b) shtetësia shqiptare; c) arsimimi; ç) përvoja profesionale; d) gjendja gjyqësore; dh) disiplina në punë; e) anëtarësia në parti politike në kohën e kandidimit; ë) qenia anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990; f) qenia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.*

51. Gjatë verifikimit sërish të kandidatit për Këshillin e Lartë Gjyqësor nuk ka mbërritur ndonjë njoftim që të jepte shkas kryerjes së një verifikimi të thelluar mbi përmbushjen nga kandidati të kriterëve të zgjedhshmërisë sipas nenit 28 të Ligjit për Statusin, duke mos pasur kështu për

kandidatin ndonjë e dhënë e ndryshme nga ato të verifikuara më parë sa i përket kritereve sipas kësaj dispozite.

III. KONKLUZIONE

52. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

53. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati i përmbush ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin dhe refuzimin e emërimit të tij si gjyqtar. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së emërimit të tij si gjyqtar.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 61, pika 2, shkronja “a” dhe nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 35 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 2, shkronja “b”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Kualifikimin për emërim të kandidatit z. {...}, i diplomuar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2022 - 2023 dhe vijimin e procedurës së emërimit si gjyqtar.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet

publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR